

---

# RAPORTI VNM-së PËR PROJEKTIN

SHËRBIME PROJEKTIMI PËR HARTIMIN E PROJEKTIT: RIKONSTRUKSION RRUGA "AZEM HAJDARI", NDERTIM I BLOKUT "ZALL MNER, FRUTIKULTURE", BLOKUT "BATHORE 4, BULCESH", BLOKUT "BATHORE 7", BLOKUT "KAMEZ 3, VALIAS", BLOKU "LAKNAS", RIKONSTRUKSION RRUGA "SHKENDIJA", NDERTIM RRUGA "HARKU I TRIUMFIT+ KUN", NDERTIM BLOKU "BATHORE 1,2", BLOKUT "BATHORE 3,4", NDERTIM KUN E PJESES FUNDORE TE KANALIT TE LAKNASIT " HEKURAN DEDA " KAMEZ.

Baza ligjore:

VKM Nr. 686, date: 29.7.2015, "Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore"

Ligji Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin Nr. 10 440, date: 07.07.2011, "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis", Shtojca II, Pika 10. Prodhime infrastrukturore / b) Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë dhe ndërtimin e qendrave tregtare dhe parkimet për makinat

*Zhvillues:* BASHKIA KAMEZ

*Vendodhja:* KAMEZ ALBANIA

## PERMBAJTJA

### 1. INFORMACION PER QELLIMIN E VNM-se DHE METODIKEN E ZBATUAR

- Përshkrim të qëllimit dhe objektivave të VNM-se
- Kuadri Ligjor Mjedisor dhe Institucional
- Kuadri Ligjor nderkombetar

### 2. VLERESIMI MJEDISOR I PROJEKTIT

- Një përshkrim i shkurtër i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi;
- Informacioni për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij;
- Një identifikim i ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;
- Një përshkrim i shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve;
- Informacioni për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara;
- Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;
- Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;
- Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;
- Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë);
- Kopje të certifikatës së specialistit/ëve për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor, që ka hartuar raportin paraprak të VNM-së.

### 3. PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL

## **HYRJE**

Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor identifikon, përshkruan dhe vlerëson efektet direkte të projektit tek njerezit, flora dhe fauna, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, klimën, terrenin dhe ndërtimi tij si dhe ndërveprimin e këtyre faktorëve me trashëgimime kulturore, sociale dhe mjedisore. Kjo temë është bazuar në parimet e veprimeve të parandalimit, dhe si e tillë politika më e mirë konsiston në mënjanimin e ndotjes dhe problemeve të tjera që janë ngritur.

Studimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) siguron një përmbledhje të të dhenave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e vendit të zhvillimit të aktivitetit duke përfshirë kushtet fizike atmosferike dhe të burimeve ujore dhe biologjike, burimet kulturore dhe gjendjen social-ekonomike të zones. Në procesin studimor të VNM perdoren informacioni dhe të dhenat ekzistuese dhe të perfituara rishtas mbi kushtet e vendit, se bashku me standardet dhe normat e zbatueshme për të vlerësuar impaktet potenciale mjedisore dhe sociale të fasiliteve të propozuara. Ky raport hartohet mbi bazen e mbrojtjes së mjedisit dhe në funksion të institucioneve vendim - marrese për licensimin ose jo të aktiviteteve të ndryshme. VNM është një proces sistematik për të përcaktuar dhe vlerësuar efektet apo ndikimet në mjedis të një veprimi apo projekti të caktuar. Në një situatë normale, ky proces aplikohet përpara se të merren vendimet dhe të fillojnë angazhimet për realizimin e projektit. Por sidoqoftë, dhe në çdo kohë, efektet sociale, kulturore dhe shëndetësore janë konsideruar si pjesë integrale e VNM-së.

## **INFORMACION PER QELLIMIN E VNM-se DHE METODIKEN E ZBATUAR**

VNM gjithashtu përfshin parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse, reduktuese dhe eliminuese të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së mjedisit nëpërmjet:

1. Marrjes në konsideratë të çështjeve të mjedisit që në fazën e përgatitjes së propozimeve në projekt.
2. Shqyrtimit të alternativave të ndryshme brenda projektit
3. Të japë një gjendje sa më reale nga pikëpamja e ndikimit dhe impaktit në mjedis nga aktiviteti që do zhvillohet.
4. Analizimin e faktorëve pozitivë dhe negativë mjedisorë, marrjen e masave zbutëse, reduktuese dhe eliminuese për ndikimet negative.
5. Nxjerrjes në dukje dhe vlerësimin cilësor të ndikimeve në mjedis të projektit.
6. Propozime dhe rekomandime të masave zbutëse të ndikimit në projekt.

## **OBJEKTIVAT AFATSHKURTER TE VNM -se JANE**

1. Përmirësim nga pikëpamja mjedisore të projektit të propozuar;
2. Të hartojë plane për menaxhimin e mjedisit dhe aksidenteve në vendin e punës;
3. Të hartojë planin për monitorimin e mjedisit për të mbajtur nën kontroll ndikimet;
4. Të informojë institucionet vendore, komunitetin dhe grupet e tjera të interesit për zhvillimin e projektit;
5. Të nxjerrë konkluzione dhe rekomandime mbi rëndësinë e projektit në lidhje me ndikimet negative dhe pozitive si dhe rëndësinë sociale të tij.
6. Objektivat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis përfshijnë përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore gjatë zbatimit apo mos zbatimit të projektit.
7. Të minimizojë ndikimet e drejtpërdrejta në mjedis dhe në radhë të parë në elementet prioritarë si ruajtja e tokës, kontrolli i zhurmave, dhe ruajtja e cilësisë së ujit dhe ajrit.
8. Të ruajë ose rehabilitojë mjedisin natyror përmes elementeve të reja të ndërhyrjes pozitive, punimeve të veçanta në kuadër të projektit ose paralel me të, të cilët sigurojnë vijueshmërinë e qëndrueshme të mjedisit biologjik duke përfshirë faunën dhe florën në mjediset përreth zonës së marrë në konsideratë.
9. Të japë informacion mbi vendndodhjen e impiantit dhe të analizojë tiparet mjedisore

10. Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me eficence;
11. Siguron qe eshte perzgjedhur alternativa me e mire e vendodhjes se projektit.
12. Siguron qe jane marre ne konsiderate teknikat me te mira te disponueshme te teknologjise se propozuar per tu aplikuar.

### **Objektivat afatgjate te VNM jane:**

Siguron dhe mbron shendetin e njeriut;  
Parashikon dhe parandalon ndryshimet/demtimit e pakthyeshme te mjedisit;  
Permireson aspektet sociale-ekonomike te projektit;  
Ndhmon ne realizimin e parimit te zhvillimit te qendrueshem te mjedisit;

### **Pershkrim i metodikes se zbatuar per hartimin e raportit te VNM-se.**

Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të projektit u ndoqën hapat e mëposhtme:  
Njohja dhe studimi i projektit, teknologjia e tij;  
Njohja me infrastrukturën ekzistuese ;  
Njohja me natyrën e operacioneve të nevojshme në mjedis;  
Njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore të zonës dhe sipërfaqes;  
Historiku i ndërveprimit mjedisor;

### **PËRSHKRIM I LEGJISLACIONIT NË FUQI**

Seksioni i mëposhtem i këtij raporti paraqet në mënyrë përmbledhese ligjet dhe normat përkatëse që janë marre në konsideratë. Miratuar në vitin 1998, Kushtetuta e Shqipërisë përcakton kornizën e përgjithshme për mbrojtjen e mjedisit, si dhe miraton parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, si dhe të drejtën e publikut për lirinë e informacionit mbi mjedisin.

Kuadri ligjor vendor Legjislacioni mjedisor është ndertuar për të mbrojtur dhe parandaluar komponente të veçante dhe të rëndësishme të mjedisit. Kështu, ndër me specifiket mund te përmendim:

Kështu, ndër me specifiket mund te përmendim:

Ligjin Nr. 10 431, date 9.6.2011 "Per mbrojtjen e Mjedisit"

Ligji Nr.10 440, date 7.7. 2011, "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis".

Ligj Nr. 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit"

Ligji Nr. 10 463, date 22.9. 2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve"

Vendim Nr. 177, date 6.3.2012 "Per ambalazhet dhe mbetjet e tyre"

Ligj Nr. 10119 date 23.04.2009 "Per planifikimin e territorit"

ligjit nr. 10266 datë 15.04.2010 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja"

Ligji Nr.9587, date 20.07.2006, "Per mbrojtjen e biodiversitetit"

Ligji Nr.10 081, date 23.02.2009 "Per Licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise".

VKM Nr. 686, date 29.07.2015, "Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore".

Vendim i KM Nr.1189, Date 18.11.2009 "Per Rregullat Dhe Procedurat Per Hartimin Dhe Zbatimin e Programit Kombetar Te Monitorimit Te Mjedisit"

Vendimi i KM Nr. 805, dt 04.12.2003 "Per miratimin e listes se veprimtarive, qe ndikojne ne mjedis, per te cilat kerkohet Leje Mjedisore".

VKM-së nr. 435 datë 12.09.2015 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë".

Vendimi i KM Nr.247, date 30.04.2014 "Per terheqjen e mendimit te publikut ne vendimmarrje per mjedisin".

Vendim i KM Nr. 123, date 17.2.2011 "Per menaxhimin e zhurmave"

Vendim i KM Nr. 313, dt. 09.05.2012 "Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis"

Vendim i KM Nr. 99, date 18.2.2005 "Per miratimin e katalogut shqiptar te klasifikimit te mbetjeve"

Vendim i KM Nr. 177, date 31.3.2005 "Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjediseve ujore pritese"

Vendim i KM Nr. 538 dt.26.05.2009 "Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregulla te tjera"

Vendim i KM Nr. 16, date 14.01.2012 "Per te drejten e publikut per te pasur informacion mjedisor"

Vendim Nr. 676, date 20.12.2002 "Per shpalljen e zonave te mbrojtura monument natyror"

VKM Nr. 575, date 24.06.2015, "Per menaxhimin e mbetjeve inerte"

Udhëzim Nr. 8, dt.27.11.2007 "Per nivelet kufi te zhurmave ne republiken e shqiperise.

Ne parlamentin Shqiptar jane miratuar edhe disa ligje ne kuader te perfshirjes se vendit tone ne Protokolle dhe marreveshje te ndryshme. Nder to permendim:

Ligji Nr. 9672 date 26.10.2000: "Per ratifikimin e konventes se Aarhusit" Per te drejten e publikut per te pasur informacion dhe perfshirjen ne vendimarrje, si dhe per tju drejtuar gjykates per ceshtjet e mjedisit.

Ligji Nr. 9334 date 16.12.2004: "Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne Protokollin e Kiotos" ne konventen per ndryshimet klimatike (UNFCCC).

Ligji Nr. 9424 date 06.10.2005: "Per ratifikimin e protokollit te vleresimit strategjik mjedisor".

Ligji Nr. 9486 date 06.03.2006: "Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne Amendamentin e Pekinit per protokollin e Montrealit" Per substancat qe hollojne shtresen e Ozonit.

Ligji Nr. 9548 date 01.06.2006: "Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne protokollin per regjistrat e shkarkimit dhe transferimit te ndotesve"

Hartimi i kesaj VNM -je dhe zbatimi i ketij projekti eshte i mbikqyrur nga disa institucionet qendrore dhe ato lokale per zbatimin me rigoroz te te gjitha ligjeve dhe normave te parashtuara ne ligjet perkatese sipas institucioneve dhe kopentecave te tyre. Hartimi i ketij raporti vnm eshte bere ne perputhje me ligjin nr. 10 440, date 07.07.2011,"per vleresimin e ndikimit ne mjedis ", ku sipas shtojcave te ketij ligji, percaktohen edhe projektet qe i nenshtrohen procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis, dhe projekti ne fjale i nenshtrohen procedures paraprake te vleresimit te ndikimit ne mjedis Shtojca II, Pika 10. Prodhime infrastrukturore , b) Projekte per zhvillime urbane, duke perfshire dhe ndertimin e qendrave tregtare dhe parkimet per makinat

## **KUADRI LIGJOR NDERKOMBETAR**

Raporti i VNM-se per projektin ne fjalë, merr ne konsideratë dhe mundohet te perqasë pjesë te tij me legjislacionin e BE mbi probleme mjedisore dhe jo vetëm. Direktivat me kryesore :

Direktiva e KE 1999/30/CE 22 Prill 199, per vlerat kufi per dioksidin e squfurit, dioksidin e azotoit dhe oksidin e azotit, PM dhe plumbit.

Direktiva 2000/60/CE e Parlamentit dhe e Keshillit te Europës,Kuadri ligjor per veprimet e komunitetit ne fushen e politikës së ujrave.

Direktivës KE 42/2001 (te Keshillit te Evropës), mbi VNMS dhe VSM.

Direktiva 2008/50, CE, e Parlamentit dhe e Keshilit te Evropës (21 Maj 2008) "Mbi cilësinë e ajrit ne mjedis, per një ajër më te pastër per Evropën".

Direktiva 75/442/CEE e Keshillit e datës 14 Korrik 1975, Mbi Mbetjet.

Direktiva 91/689/CEE e Keshillit e datës 12 Dhjetor 1991, Mbi Mbetjet e Rrezikshme.

Direktiva 2001/42/CE e Keshillit dhe e parlamentit Evropian e datës 27 qershor 2001, Mbi vleresimin e Pasojave te Planeve dhe Programeve te Caktuara mbi Mjedisin.

Direktiva 85/337/CEE e Keshillit e datës 27 Qershor 1985, Mbi Vleresimin e Pasojave te Disa Projekteve Publike dhe Private mbi Mjedisin.

Direktiva e Keshilit 96/62/EC Mbi vleresimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit ne mjedis.

Direktiva 1999/30/CE, Në lidhje me vlerat kufi per NO2, NOx, SO2, lëndët grimcore dhe Pbnë ajër.

Direktiva e Komisionit Evropian CEE/CEEA/CE 78/659 per cilesine e ujrave te embla

Direktiva 99/61/CE Per gropat e mbetjeve.

a. Një përshkrim i shkurtër i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi;

Zona ndodhet në Njësinë Administrative Kamez.



Fig. 1 Rr. E RE



Fig. 2 Rr. SHKENDIJA



Fig. 3 Rr. VLLAZERIMI



Fig. 4 Rr. BUTRINTI

#### FLORA


Nga sipërfaqia totale prej 1.586 km<sup>2</sup> qarkun e Tiranës, pyjet mbulojnë 32% të kësaj sipërfaqe. Gjendja e këtyre në përgjithësi është e mirë. Një pjesë e rëndësishme e fondit pyjor në qarkun e Tiranës përbëhet nga zonat që kanë statusin e zonave të mbrojtura. Në territor gjendet një shumëllojshmëri e bimëve dhe kafshëve të egra që formojnë habitatet e tyre natyrore. Vegjetacioni është i larmishëm dhe fillon që nga zonat bregdetare dhe deri në majat më të larta të maleve të këtij qarku. Struktura pyjore përbëhet nga Pisha e egër, Pisha e butë, Plepi, Selvia, Akacia dhe shkurret e Makias.

#### FAUNA

Në zonat pyjore të qarkut jetojnë kafshë të ndryshme si ujku, dhelpra, derri i egër, arriu i murmë, lepuri i egër, macja e egër dhe një numër i shumë shpendësh. Habitatet natyrore janë një pasuri e paçmuar që ndikon në cilësinë e mjedisit të këtij qarku. Prandaj mbrojtja e biodiversitetit të zonës përbën një prioritet dhe është e kushtëzuar drejtpërdrejt nga ruajtja e habitateve natyrore të kësaj zone.

b. Informacioni për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij;

Në zonën e zbatimit të këtij projekti nuk ka burime ujore të identifikuara, ato ndodhen në distancë.



c. ***Një identifikim i ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;***

Aktivitetet që do të japin ndikime të mundshme negative në mjedis gjatë të gjitha fazave të zbatimit të projektit, asaj parapregatitore, të ndërtimit të objektit janë veprimtaritë si:

- punime prishje, germimi;
- transport lëndesh ndërtimi;
- krijim mbeturinash te ngurta e te lengeta; etj.

### **Ndikimi mbi atmosferën**

Efektet e shkaktuara nga zbatimi i projektit mbi cilësinë e ajrit janë të kufizuara në periudhën e kryerjes së punimeve për ndërtimin për objekteve. Emetimet në ajër do të vijnë nga përhapja e pluhurave të materialeve të ndërtimit dhe materialit të germuar të sipërfaqes së tokës . Nga punimet ndërtuese do të ketë përhapje të pluhurave nga qarkullimi i mjeteve, përdorimi i reres, zhavorrit, proceset e betonimit dhe shtrimit të sipërfaqeve përreth, si dhe nga transporti i dheut të germuar. Gjithashtu djegia e lëndës djegëse që do të vijë nga automjetet e rënda të punimeve.

Ndër efektet kryesore janë:

- Përhapja e pluhurit gjatë fazës së prishjes së objektit ekzistues dhe germimit të sipërfaqes së tokës dhe pluhurat e materialeve që do të përdoren gjatë ndërtimit të objektit
- Cilirimi i gazeve të djegies nga proceset e ndryshme dhe motorët e makinerive që do të përdoren ,
- Ndikimi i erës në përhapjen e pluhurit në ajër

Impakti i projektit mbi cilësinë e ajrit mund të konsiderohet i pranueshëm.

### **Shkarkimet në ujë**

Nuk kemi ndotje të ujerave nëntokesore. Ujerat që dalin nga aktiviteti i ndërtimit të objektit janë ujera të cilat lindin si rrjedhojë e aktivitetit të lagës së kantierit, larjes së gomave të automjeteve dhe ujerat e rreshjeve nga

kushtet atmosferike. Gjate ndertimit, ne varese edhe te rreshjeve te shiut, mund te grumbullohet sasi e konsiderueshme e ujerave dhe si rrjedhoje mund te jete i nevojshem grumbullimi i ketyre ujerave dhe orientimi i tyre ne sistemin e kanalizimeve, pjeserisht ato filtrojne nentoke. Si rrjedhoje, punimet e ndertimit nuk duhet te tejzgjaten dhe te kalojne afatet e percaktuara ne lejen e ndertimit. Nuk duhet te shkarkohen lende te demshme ne mjedisin e kantierit pasi mund te filtrojne se bashku me ujerat e rreshjeve dhe si rrjedhoje te ndosin ujerat nentokesore. Ne kantier nuk do te magazinohen materiale te rrezikshme dhe si rrjedhoje nuk do te kete ndotje te ujerave nentokesore ose siperfaqesore. Mundesite e ndotjes, mund te vijne vetem nga derdhja e hidrokerbureve ose e lubrifikanteve gjate furnizimit te mjeteve te renda te punes. Nje faktor tjetër mund te jene ujerat e pastrimit e te larjes se kazaneve te betoniereve gjate shkarkimit te betonit ne kantier. Keto te fundit, nuk duhet te shkarkojne ujerat ne cdo mjedis rrethanor, ato duhet te shkarkohen ne mjedise te caktuara dhe ne kantieret e prodhimit te betonit. Punimet e themeleve do te jene per nje periudhe kohore teper te shkurter dhe mundesia e ketyre ujerave zvogelohet ndjeshem.

### **Ndikimet ne tokë**

Ndikimet në tokë do të jenë negative gjatë ndërtimit të objektit. Mund të kemi:

- Ndryshim i topografisë lokale të tokës
- Erozioni i tokes shkaktuar nga gërmimet që do të kryhen por edhe humbje e qendrueshmerise se truallit
- Ngjeshja e tokës nga mjetet qarkulluese në zonën rreth objektit gjatë punimeve të ndertimit;
- Shkarkimi/clirimi aksidental gjatë transportit i lëndëve djegëse, vajore, kimike, lëndëve të rrezikshme, etj ne tokë,

Do të realizohen punime gërmimi dhe teracimi të terrenit.

Impakti i projektit mbi tokën mund të konsiderohet i pranueshëm.

### **Mbetjet e prodhuara**

Në bazë të VKM Nr. 99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, mbetjet e ngurta qe do te prodhohen nga ndertimi do te jene mbetje te tilla si:

17 Mbetjet e ndërtimit (përfshirë dheun e gërmuar dhe inertet nga prishjet);

17 02 03 plastike,

15 01 01 materiale letre e kartoni,

17 04 07metale,

17 02 01 mbetje organike

17 09 04materiale inerte te prodhuara nga punimet,

17 04 05hekur,

17 01 01beton, asfaltobeton, si dhe

17 05 04dheu qe do te largohet nga sheshi i ndertimit

20 Mbetjet komunale (mbetjet e familjeve, dhe mbetje të ngjashme tregtare, industriale dhe institucionale)

Grumbullimi i mbetjeve duhet te jete i diferencuar qe ne vendburim. Mbetjet inerte,dheu i germuar, dhe mbetjet e ambalazheve te paletave te materialeve te ndertimit duhet te trajtohen ne menyre te vecante.Mbetjet duhet të dërgohen në një landfill të miratuar.

Depozitim i mbetjeve inerte do të bëhet ne perputhje me VKM Nr.575,date 24.06.2015 “Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte”.

**Transporti i mbetjeve inerte do të bëhet me mjete teknologjike të pajisur me licensë të tipit III.2.B në bazë të ligjit Nr. 10463, date 22.09.2011, “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve” i ndryshuar dhe të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të VKM nr.229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme” si dhe VKM nr.371, datë 11.06.2014“Për percaktimin e rregullave per dorezimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorezimit të mbetjeve të rrezikshme” .** Impakti i mbetjeve të prodhuara mbi mjedisin mund të konsiderohet i pranueshëm.

### **Ndikimi nga rritja e trafikut dhe e zhurmave**

Zhurmat janë një ndikim i pashmangshëm mbi mjedisin gjatë ndërtimit. Zhurma mund të kufizohet duke ndjekur praktikat e mirë-administrimit (pajisje/makineri të kalibruara) që nënkuptojnë se punimet do të kryhen vetëm gjatë orarit të rregullt të turneve të punës.



Pajisjet e ndërtimit do të plotësojnë të gjithë standartet e zbatueshme të Direktivës së BE 2000/14/EC, e Majit 2000. Kjo Direktivë zbatohet për prodhuesit e pajisjeve që shkaktojnë zhurmë. Të gjithë pajisjet duhet të mirëmbahen në gjendje të mirë pune.

Oraret e transportimit të materialeve të ndërtimit në rrugët e daljes do të caktohen me kujdes në mënyrë që të mënjanohet çdo shqetësim i trafikut lokal.

Realizimi i punimeve të ndërtimit, do të shoqërohet me përdorimin e makinerive të rënda, kompresorëve, pompave, betonierave dhe pajisjeve të tjera për përgatitjen e zonës dhe ndërtimin e objektit. Rritja e trafikut shkaktohet nga transporti i personelit dhe i materialeve, ngarkim-shkarkimi i materialeve, do të shkaktojë emetim zhurmash dhe vibracionesh. Zhurmat që do të prodhohen do të vijnë kryesisht nga mjetet e transportit, nga makineritë që do të përdoren gjatë proceseve të ndryshme të punës, zhurma e prodhuar nga vetë punëtorët që do të punojnë në këtë kantier, etj. Do të shkaktohen vibrime shqetësuese gjatë punimeve.

Impakti i projektit mbi zhurmat dhe vibracionet mund të konsiderohet i pranueshem.

**Kontraktori është i detyruar të marrë masa për minimizimin e zhurmave në përputhje me Ligjin nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, Udhëzimit Nr.8 date 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara”.**

### **Ndikimi mbi peisazhin**

Dy janë efektet kryesore që mund të priten gjatë fazës së ndërtimit të objektit:

- Një efekt i dëmshëm si rezultat i parregullsisë dhe kaosit që gjeneron organizimi i papërshtatshëm i depozitimit të materialeve, prania e mjeteve dhe makinerive, etj.;
- Një efekt i përgjithshëm jo estetik shkaktohet nga grumbujt e materialeve dhe makineritë, të cilat çojnë në një ndryshim të peisazhit (ngjyrat, teksturën, etj.) dhe alteron karakteristikat vizuale.

Impakti i projektit mbi peisazhin mund të konsiderohet i moderuar (në nivel mesatar).

### **Erërat**

Gjatë realizimit të punimeve të ndërtimit, nuk priten erëra. Efekti potencial i këtij impakti mund të konsiderohet i parëndësishëm.

### **Ndikimet mbi klimen**

Efektet e shkaktuara nga zbatimi i projektit mbi klimën do të jenë të parëndësishëm sepse nuk parashikohet asnjë ndryshim të elementeve klimatike.

Impakti i projektit mbi klimën mund të konsiderohet jo i rëndësishëm.

### **Ndikimet në biodiversitet**

Zona pozicionohet në një territor të zënë në pjesën më të madhe nga ndërtimet. Zona në shqyrtim zotëron kryesisht lloje të bimësisë së kultivuar në anë trotuare në anë të rrugëve. Konstatohet se mungojnë ambjentet publike rekreative. Sipërfaqet e gjelbëruara janë ato sipërfaqe të lira të pashfrytëzuara nga njerëzit, që në zonë vihen re në hapësirat bosh të krijuara ndërmjet pallateve në pjesën veriore të zonës. Këto të fundit kanë nevojë për sistemim dhe rikualifikim. Rrugët paraqiten në gjendje të amortizuar, sistemi ujësjellës kanalizime kalon pranë zonës në studim, ashtu edhe ai elektrik. Si rrjedhojë, problemet kryesore që evidentohen në këtë zonë janë:

1. Mungesa e parkimeve publike të sistemuara;
2. Mungesa e ambienteve rekreative në të cilat të zhvillojnë aktivitetet e tyre të gjitha grupmoshat duke filluar që nga parashkollorët, shkollorët, adoleshentët, të rriturit dhe të moshuarit e këtij komuniteti;
3. Grumbullimet e mbetjeve në afërsi
4. Ndotja akustike

Ndikimet e mundshme mbi burimet ekologjike dhe biodiversitetin gjatë fazës së ndërtimit përfshijnë tjetërsimin e vendit si habitat i modifikuar nga njeriu e jo natyror, shqetësime të kafshëve (kryesisht shpendëve) të mjedisit urban ose migrim i përkohshëm i atyre të zonës më larg sheshit të ndërtimit shkaktohet nga zhurma, dhe prania e njerëzve dhe mekanizmave, ndotjet nga pluhuri dhe emetimi i substancave të ndotura, rreziku i zjarrit në afërsi të shesheve të ndërtimit, çojnë në degradimin e kushteve të nevojshme që mbështesin biodiversitetin. Duke qënë se vendi ku do të ndërtohet objekti është mjedis urban në përgjithësi karakterizohet me vlera të uleta përse i përket biodiversitetit. Në kushtet e habitateve artificiale dhe mungesë të specieve endemike, të rralla ose të rrezikuara ndikimi është i ulët.

Ndikimet në faunë

Ndikimet kryesore në grupe të ndryshme të faunës nga ndërtimi i objektit të propozuar mund të klasifikohen si shqetësim për elementët faunistik urban. Ndërtimi përfshin pastrimin e vegjetacionit në vatra të pakta të gjetura, gjurmimet të dheut, dhe lëvizja e mjeteve apo pajisjeve mbi rrugët dhe terren, ngarkimin dhe shkarkimin e materialeve dhe aktiviteteve të tjera mund të rezultojë në lëndime apo eliminimin e kafshëve. Për pozicionin e sheshit të ndërtimit, ndikimet e tilla nuk mund të jenë të rëndësishme, pasi nuk përfshijnë një numër të madh të organizmash të cilat nuk janë të konsoliduara si komunitete apo popullata. Elementët faunistikë nuk karakterizohen nga ndjeshmeri e veçantë që të ndikohen në mënyrë specifike apo që të jenë të paaftë për të kompensuar humbjet në mënyrë të arsyeshme, ose janë tashmë të ulët në numër.

## **Ndikimi ne Mjedisin Social**

Ndikimi i këtij projekti ne mjedisin social do te jete pozitiv. Perjashtim ben vetem periudha kohore gjate se ciles do te kryhen punimet ndertimore.

Objektivat kryesorë të zhvillimit urban për zonat rezidenciale janë:

- Përmirësimin e kushteve të jetesës,
- Krijimin e shërbimeve dhe faciliteteve të reja në nivel urban dhe lokal (lagje),
- Rritjen e cilësisë dhe sasisë së parqeve dhe lulishteve
- Përmirësimin e cilësisë së stokut të banesave,
- Krijimin e oportuniteteve për ngritjen e shoqatave të pronareve dhe/ose shoqatavetë ndryshme etj,
- Krijimin ose rritjen e oportuniteteve të komunikimit midis banorëve të lagjeve.

Me përjashtim të përdorimit ekzistues të tokës, ndërtimet në këto zona mund t'i dedikohen funksioneve të mëposhtme:

- Rezidenciale dhe Faciliteteve që lidhen me to si garazhe, magazina, qilare;
- Dyqane pakice;
- Punishte artizanati që nuk bien ndesh me zonat e banimit;
- Facilitete publike të interesit të përgjithshëm;
- Zyrat publike dhe private (banka, zyra postare etj.);
- B&B, pensione dhe facilitete turizmi dhe zyra.
- Struktura shërbimi shendetësor, social etj

### **d. *Një përshkrim i shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve;***

Ky raport hartohet mbi bazen e parimit te mbrojtjes se mjedisit dhe ne funksion te institucioneve vendim-marrese per licensimin ose jo te aktiviteteve te ndryshme te cilat mund te kene ndikim ne mjedis.

Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme veprimtarite te cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet baze te mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- Parimet e mbrojtjes se mjedisit
- Parimi i zhvillimit te qendrueshem
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes se burimeve natyrore
- Parimi i zevendesimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes se integruar
- Parimi i pergjegjesise se ndersjelle dhe bashkepunimit
- Parimi "Ndotesi paguan"
- Parimi i se drejtes per informim dhe i pjesemarrjes se publikut
- Parimi i nxitjes se veprimtarive per mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nenkupton mbrotjen e integruar te perbersve te mjedisit nga ndotja, si vecmas, ashtu dhe ne kombinim, duke pasur parasysh nderveprimet ndermjet tyre dhe qysh ne fazen e planifikimit te zhvillimit te nje territori te caktuar.

- Mbrojtja e Perbersve te mjedisit klasifikohet ne:

- Mbrojtja e ajrit
- Mbrojtja e ujerave
- Mbrojtja e tokes
- Mbrojtja e natyres
- Ndryshimet klimatike

#### Shkarkimet ne uje

Ujerat qe dalin nga aktiviteti i ndertimit jane ujera te cilat lindin si rrjedhoje e aktivitetit te lagies se kantierit, larjes se gomave te automjeteve para daljes nga kantieri dhe ujerat e rreshjeve nga kushtet atmosferike. Gjate ndertimit, ne varesi edhe te rreshjeve te shiut, mund te grumbullohet sasi e konsiderueshme e ujerave dhe si rrjedhoje mund te jete i nevojshem grumbullimi i ketyre ujerave dhe orientimi i tyre ne sistemin e kanalizimeve , pjeserisht ato filtrojne nentoke. Si rrjedhoje, punimet e ndertimit nuk duhet te tejzgjaten dhe te kalojne afatet e percaktuara ne lejen e punimeve te ndertimit. Nuk duhet te shkarkohen lende te demshme ne mjedisin e kantierit pasi mund te filtrojne se bashku me ujerat e rreshjeve dhe si rrjedhoje te ndosin ujerat nentokesore.

Ne kantier nuk duhet te magazinohen materiale te rrezikshme dhe si rrjedhoje mos te kete ndotje te ujerave nentokesore ose siperfaqesore. Mundesite e ndotjes, mund te vijne vetem nga derdhja e hidrokarbureve ose e lubrifikanteve gjate furnizimit te mjeteve te renda te punes. Ne kantierin e sherbimit te mjeteve te punes te krijohen disa kushte te tilla qe te mos depertojne lende hidrokarbure ne toke, por te grumbullohen ne nje vaske dekantimi.

Shkarkimet ne ujera jane me efekte negative, kjo per shkak te shpelarjes nga rreshjet te blozes se gazeve te automjetve, te pluhurit te ferrotave(vecanerisht ne zona me trafik te renduar), si dhe ne sasi te vogel, vajra lubrifikante, hidrokarbure nga rrjedhjet e zakonshme te automjeteve, apo nga rrjedhjet ne rastet e aksidenteve rrugore.

#### Emetimet ne ajer

Emetimet ne ajer do te vijne nga perhapja e pluhurave te materialeve te ndertimit, nga prishja e objektit ekzistues dhe materialit te germuar te siperfaqes se tokes si dhe nga djegia e lendes djegese,qe do te vije nga automjetet e renda te punimeve. Pra mund te themi se niveli i shkarkimeve do te jete ne nivel mesatar, nga punimet ndertimore, por i rendesishem nga trafiku i krijuar gjate punimeve(qarkullim i pjesshem). Gjithashtu mjetet rrugore qe qarkullojne duhet te jene konform normave te percaktuara dhe lejuara te shkarkimeve ne ajer, si dhe te testuara nga Qendra e Kontrollit Teknik te automjeteve.

Keto mjete duhet te plotesojne patjeter kushtet teknike te qarkullimit rrugor, te mos ngarkohen me shume se kapaciteti i projektuar, te mbulohet karrocera me mushama te posame, si dhe te lahen rregullisht kur dalin nga kantieri i ndertimit dhe nga kantieri i prodhimit te betonit, asfaltit apo te inerteve ne sheshin e depozitimit te dheut/inerteve te germuara. Gjate sezonit te thate rekomandohet lagia e vazhdueshme e kantierit.

#### Zhurmat dhe vibrimet

Zhurmat qe do te prodhohen do te vijne kryesisht nga mjetet e transportit, mjetet e germimit, mjetet e prerjes se hekurit, si dhe nga perdorimi i vinçave te ndryshem, gjeneratoreve, zhurma e prodhuar nga vete personat qe do te punojne per kete kantier, proceset e hedhjes se betonit, asfaltimi i ambienteve perreth objektit,etj. Punetoret qe do te ndodhen ne mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin mund te perdorin masa mbrojtese per shqisat e degjimit. Kjo duhet te kihet parasysh nga drejtuesi teknik i punimeve.

#### Mbetjet e prodhuara

